



# EDUKIMI MJEDISOR



Qershor 2024

Edukimi mjedisor i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Ai është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshinë studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë çarkulluese. Nxënësit përfshihen në mbrojtjen e natyrës dhe njëkohësisht e duan edhe më shumë atë.

**“E vetmja rrugë nëse do të përmirësojmë cilësinë e mjedisit,  
është përfshirja e të gjithëve”**

**Richard Rogers**

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në të 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndërmarrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjediseve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehje dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit



ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit Përmes këtij manuali mujor Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura paraqet aktivitetet e zhvilluara nga 12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura, me nxënësit e shkollave të ndryshme në mbarë vendin dhe atyre që ndodhen pranë ZM-ve apo në zonat rurale, përgjatë muajit qershor 2024, Aktivitetet janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

Nxënës të përfshirë **500**

Specialistë të angazhuar **22**

Orë mjedisore të realizuara **25**

**25** Shkolla të përfshira

**25** Mësues të përfshirë

# “EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR



## 1 qershor 2024, Censusi i Pelikanit Kaçurrel

Specialistët e AdZM-së Shkodër në bashkëpunim me ekspertë të organizatës PPNEA, Well Point dhe Natyralistë zhvilluan Censusi-in e Pelikanit Kaçurrel (*Pelecanus crispus*) në Rezervatin Natyror të Menaxhuar “Liçeni i Shkodrës” dhe Peizazhin Ujor Tokësor të Mbrojtur “Lumi Buna - Velipojë”, të cilat janë ndër ligatinat më të rëndësishme në vend dhe rajon.

## 5 qershor 2024, Dita Botërore e Mjedisit

Në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit AdZM Shkodër në bashkëpunim me PPNEA, Well Point, Bashkinë Shkodër, Natyralistë dhe nxënës të shkollës 9-vjeçare “Pjetër Gaci” dhe shkolla e Mesme e Bashkuar “Lucë Agraja”, zhvilluan një aksion pastrimi në Rezervatin Natyror të Menaxhuar “Liçeni i Shkodrës” dhe në Lumin Buna, pjesë e Peizazhit Ujor Tokësor të Mbrojtur “Lumi Buna - Velipojë”. Përmes këtij aksioni mundësuam pastërtinë e peizazhit në zonë.

rezervat natyror    peizazh natyror    vrojtimi i shpendëve  
aksion pastrimi    rrëqebull



## **6 qershor 2024, Dita Botërore e Mjedisit për nxënësit e shkollës “Prekë Gjoni”**

Nën sloganin “Mbroni mjedisin tuaj për një botë më të gjelbër dhe të shëndetshme” zhvilluam një tjetër aktivitet në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit. Së bashku me nxënës të shkollës 9-vjeçare “Prekë Gjoni” zhvilluam një orë të hapur mjedisore në mjediset e oborrit të kësaj shkolle. Nëpërmjet aktivitetit të mbjelljes, kujdesit për bimët dhe kopshtin botanik, nxënësit dhanë mesazhe sensibilizuese për gjelbërimin, mbrojtjen dhe kujdesin që duhet të kemi për mjedisin.

---

## **11 qershor 2024, Dita Botërore e Rrëqebullit**

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Rrëqebullit (Lynx lynx) në bashkëpunim me Protection and Preservation of Natural Environment in Albania, specialistët e AdZM-së Shkodër zhvilluan një orë mjedisore me nxënës të klasës së VII-të të shkollës 9-vjeçare “Prekë Gjoni”. Nëpërmjet prezantimeve, vizatimeve dhe lojërave të ndryshme përcollëm mesazhe për mbrojtjen e rrëqebullit.

---

## **13 qershor 2024, mbjellja e fidanëve të shelgut në PM “Lumi Buna - Velipojë”**

Në bashkëpunim me PPNEA, Well Point si dhe nxënës të shkollës 9-vjeçare “Pjetër Gaci” zhvilluam një aksion mbjellje me fidanë shelgu (Salix alba) në brigjet e Lumit Buna, pjesë e Peizazhit të Mbrojtur “Lumi Buna - Velipojë”. Po ashtu, realizuam edhe një ekspeditë vrojtimi të shpendëve me dylbi, ku nxënësit u njohën me shpendët folenizues dhe jo vetëm, të cilët ndodhen në zonë.



# “EDUKIMI MJEDISOR”, KUKËS



## 11 qershor 2024, Dita Botërore e Rrëqebullit

Në kuadër të kësaj dite e cila po festohet vitet e fundit në shume vende të Evropës, më datë 11 qershor të çdo viti AdZM Kukës me mbështetjen e “Perspektiva të reja”, PPNEA dhe në bashkëpunim me nxënës të qendrës “Aiden Academy”, zhvilluan një orë mjedisore në natyrë me temë “Njohja me Rrëqebullin e Ballkanit”. Nxënësit me anë të lojërave dhe recitimeve të ndryshme u njohën me Rrëqebullin e Ballkanit si specie në rrezik zhdukje, karakteristikat e tij, shpërndarjen etj. Rrëqebulli i Ballkanit është prezent në parkun natyror Korab-Koritnik, Munellë dhe në parkun kombëtar “Alpet e Shqipërisë”. Ruajtja, kujdesi dhe sensibilizimi për mbrojtjen e kësaj specie në rrezik zhdukje është detyrë e gjithsecilit prej nesh.

Rrëqebulli i Ballkanit

specie në rrezik

sensibilizim

# “EDUKIMI MJEDISOR”, DIBËR



## 12 qershor 2024, Dita Botërore e Rrëqebullit me nxënësit e shkollës “Myslim Shehu”

AdZM Dibër realizoi një orë mjedisore në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Rrëqebullit me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Myslim Shehu”. Specialistët me anë të ushtrimeve ndanë informacione të ndryshme rreth rrëqebullit dhe përmes lojërave të ndryshme nxënësit mësuan më shumë për Rrëqebullin e Ballkanit si dhe me mënyrat e mbrojtjes së tij.

## 20 qershor 2024, ekspeditë në natyrë

AdZM Dibër realizoi një orë mjedisore në natyrë me nxënësit e gjimnazit “Fiqiri Dine”. Bashkë përshkuam shtegun “Fshati Tejz – Liqeni i Zi, Radomirë”. Kjo është një mënyrë shumë efektive për t’u njohur me zonat e mbrojtura dhe punën që realizon AdZM Dibër.

Rrëqebulli i Ballkanit

shteg

ekspeditë





# “EDUKIMI MJEDISOR”, LEZHË



## 5 qershor 2024, Dita Botërore e Mjedisit

Në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit stafi AdZM Lezhë së bashku me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Nikë Tome Prela" Gorre, zhvilluan disa aktivitete ku qëllimi kryesor ishte informimi dhe rritja e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e natyrës. Këtë e arrijmë duke inkurajuar fëmijët për të mbjellë në mënyrë aktive pemë dhe zvogëluar nivelin e ndotjes, duke u angazhuar në riparimin e mjediseve që janë degraduar nga ndotja dhe shpyllëzimi, si dhe duke ruajtur dhe promovuar ekosistemet që janë ende të paprekura. Në fund të aktivitetit, fëmijëve i'u shpërndanë certifikata mirënjohje për angazhimin e tyre maksimal në edukimin mjedisor për përkujdesjen e natyrës.

## 11 qershor 2024, Dita Ndërkombëtare e Rrëqebullit

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Rrëqebullit të Ballkanit specialistët e AdZM Lezhë së bashku me nxënësit e klasës së katërt të shkollës 9-vjeçare "Reps", prezantuan materiale informuese dhe ilustruese për nxënësit në lidhje me rrëqebullin, karakteristikat fizike të tij, kërcënimet, zonën e shpërndarjes etj. Pas prezantimit fëmijët punuan në mënyrë të pavarur disa pyetësor duke testuar njohuritë e marra, por edhe duke u argëtuar njëkohësisht. Është shumë e rëndësishme të rritet ndërgjegjësimi i të rinjve për mbrojtjen e këtij lloji të rrallë gjatari.

ndërgjegjësim

edukim mjedisor

shpyllëzim

rrëqebull

gjitarë





## 5 qershor 2024, Dita Botërore e Mjedisit

Në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit, specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një sesion informues në natyrë me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Selman Ali Xaka” Nojë, Krujë. Gjatë kësaj ore mjedisore, nxënësit mësuuan disa informacione rreth Parkut Natyror “Qafështamë”, florës dhe faunës që gjendet në këtë park, monumenteve të natyrës dhe shumë informacione të tjera interesante. Në përfundim të këtij sesiioni së bashku me nxënësit zhvilluam një aktivitet argëtues të ashtëquajtur “Në kërkim të thesarit” ku u angazhuan 100% në zbatimin e tij me rigorizitet. Aktivitetet në natyrë ngjallin interes dhe kënaqësi për t’u zhvilluar nga fëmijët.

park natyror

flora dhe fauna

monumente të natyrës



# “EDUKIMI MJEDISOR”, TIRANË



## 5 qershor 2024, Dita Botërore e Mjedisit

Nxënësit e Kolegjit “Turgut Ozal”, Tiranë u njohën me rëndësinë e Ditës Botërore të Mjedisit nëpërmjet prezantimit me temë “Për një mjedis më të pastër”. Nëpërmjet disa ushtrimeve ata u njohën me disa nga ndotësit e mjedisit dhe me mënyrat se si ti parandalojmë ato. Nxënësit nëpërmjet posterave dhanë mesazhe sensibilizuese për një mjedis më të gjelbër dhe të pastër. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte ndërgjegjësimi i brezave të rinj për të arritur ndryshime pozitive në mbrojtjen e mjedisit.

## 7 qershor 2024, me nxënësit e shkollës “Vatra e Dijes”

Specialistët e AdZM Tiranë realizuan një orë të hapur mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Vatra e Dijes” pranë Qendrës së Vizitorëve “Mali i Dajtit”. Ata u njohën me larmishmërinë e biodiversitetit, florës dhe faunës dhe rëndësinë e shtigjeve dhe monumenteve natyrore që ndodhen në këtë park. Ndërgjegjësimi i të rinjve mbi vlerat dhe ruajtjen e resurseve natyrore të parkut është tepër i rëndësishëm.

## 11 qershor 2024, Dita Ndërkombëtare e Rrëqebullit

Së bashku me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Shëngjergj”, zhvilluam një sesion informues mbi prezencën e rrëqebullit në disa zona të mbrojtura të vendit tonë, habitatin në të cilin kjo specie jeton si dhe nga se kërcënohet që të zhduket. Nxënësve iu demonstrua një mënyrë e thjeshtë monitoruese me anë të kamerave kurth, të cilat shërbejnë për të na ndihmuar në kontrollin dhe ruajtjen e kësaj specie të rrezikuar. Kjo orë pati si qëllim edukimin e të rinjve lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen e rrëqebullit.

ndotës të mjedisit

mbrojtje e mjedisit

resurse natyrore

shtigje dhe monumente natyrore



# “EDUKIMI MJEDISOR”, ELBASAN



## 3 qershor 2024, Dita Botërore e B biçikletave

Dita Botërore e B biçikletave festohet çdo vit në vende të ndryshme të botës, me qëllim sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin për të përdorur sa më shumë biçikleta dhe evitimin e mjeteve të tjera të transportit, të cilat shkaktojnë ndotje të ajrit dhe trafik të rënduar. Në bashkëpunim me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar "Isak Alla" Zgosht, u realizua një orë mjedisore e veçantë e shumë argëtuese. Përshkruam shtegun e biçikletave në Fushë Studën, pjesë e Parkut Kombëtar "Shebenik". Nëpërmjet kësaj shëtitjeje me biçikleta, nxënësit u njohën me bukuritë e zonës dhe peizazheve magjepsëse që ky park ofron.

## 5 qershor 2024, Dita Botërore e Mjedisit

Dita Botërore e Mjedisit kremtohet në datën 5 qershor të çdo viti dhe është një mundësi që njerëzit në të gjithë botën të mendojnë rreth efekteve negative të shkatërrimit të mjedisit, si në nivel lokal ashtu dhe global. Specialistët e AdZM Elbasan në bashkëpunim me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Shaban Leka" Xhyrë, zhvilluan një aktivitet pastrimi me qëllim sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e brezit të ri në mbrojtjen dhe kujdesin për mjedisin dhe ambientin ku jetojnë. Të pajisur me mjetet e nevojshme, të gjithë së bashku arritën të pastronin mjedisin e shkollës dhe mjediset përreth saj.

## 11 qershor 2024, Dita Botërore e Rrëqebullit të Ballkanit

Rrëqebulli i Ballkanit (Lynx lynx) është një specie në rrezik zhdukjeje. Për këtë arsye kjo ditë ka si qëllim sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e tij. Në kuadër të kësaj dite, specialistët e AdZM Elbasan në bashkëpunim me organizatën PPNEA, organizuan një orë mjedisore argëtuese dhe informuese për rrëqebullin, me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Vilson Blloshmi". Gjithashtu nxënësit realizuan një lojë interesante, me disa karakteristika dhe cilësi të rrëqebullit. Në fund, ata dhanë mesazhin sensibilizues "Mbroni Rrëqebullin e Ballkanit! Thuaj "JO" gjuetisë së

sensibilizim dhe ndërgjegjësim vlera natyrore

aktivitet pastrimi mjedis i pastër Rrëqebulli i Ballkanit (Lynx lynx)



# “EDUKIMI MJEDISOR”, FIER



## 5 qershor 2024, Dita Botërore e Mjedisit

Në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit, AdZM Fier zhvilloi një bashkëbisedim me studentët e Masterit Shkencor Biologji-Mjedisi Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës. Me studentët dhe profesorët botanist u diskutua mbi rëndësinë e ruajtjes së habitateve. Pjesë e rëndësishme e ditës ishte edhe puna në terren, ku studentët monitoruan dhe u njohën me habitate të ndryshme të Parkut Kombëtar “Divjakë-Karavasta” duke kryer edhe vëzhgime rreth bimësisë tipike të parkut.

## 10 qershor 2024, Dita Botërore e Oqeaneve

Në kuadër të Ditës Botërore të Oqeaneve, AdZM Fier zhvilloi një aktivitet pastrimi së bashku me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar Çermë-Sektor në plazhin e Divjakës. Nëpërmjet vizatimeve, nxënësit përçuan mesazhe tepër të rëndësishme për mbrojtjen e natyrës.

botanist ruajtje e habitateve bimësi tipike

mbrojtja e natyrës



## 5 qershor 2024, Dita Botërore e Mjedisit

Në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit specialistët e AdZM Berat realizuan një orë edukimi mjedisor me nxënësit e shkollës 9-vjecare "1 Maji", përgjatë së cilës informuan mbi pasojat e mbetjeve në shëndet dhe mjedis. Më pas nxënësit punuan në grupe për të zhvilluar projektin me temë "Kontributi im për mjedisin".



## 11 qershor 2024, Dita Botërore e Rrëqebullit të Ballkanit

Në kuadër të kësaj dite, specialistët e AdZM-së Korçë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së 8-të të shkollës “Rezistenca e Goricarëve”, në Parkun Kombëtar “Prespë”. Me anë të informimit dhe argëtimit, nxënësit u njohën me karakteristikat e specieve të rrëqebullit, statusin e tij, habitatin ku jeton si dhe rolin që luan në zinxhirin ushqimor. Nxënësit u argëtuan dhe mësuan më tepër, nëpërmjet pyetësorëve të zhvilluar në lidhje me këtë specie.



# “EDUKIMI MJEDISOR”, GJIROKASTËR



## 5 qershor 2024, Dita Botërore e Mjedisit

Me rastin e Ditës Botërore të Mjedisit, AdZM Gjirokastër në bashkëpunim me vogëlushët e kopshtit Dervician kanë zhvilluar një orë mjedisore, me qëllim të nxisin ndryshime pozitive në mbrojtjen e mjedisit dhe për të edukuar të vegjëlit.

## 6 qershor 2024, ekspeditë në natyrë

AdZM Gjirokastër në bashkëpunim me shkollën jopublike "Frymë Dashurie", Gjirokastër ka zhvilluar një ekskursion në Parkun Natyror "Bredhi i Sotirës". Fëmijët u njohën nga afër me llojet e bimëve të parkut si dhe gjallesat shtazore që jetojnë në këtë park. Në përfundim të ekspeditës, fëmijët zhvilluan lojëra zbavitëse me njëri-tjetrin.

ndryshime pozitive

bimët në park

gjallesa shtazore



# “EDUKIMI MJEDISOR”, VLORË



## 06 qershor 2024, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Vlorë zhvilluan një orë mjedisore së bashku me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Kafil Malaj” në Bishan. Në fokus të kësaj ore mjedisore ishte ndërgjegjësimi për ruajtjen e natyrës dhe mjedisve që na rrethojnë. Nxënësit kuptuan faktorët që ndotin mjedisin, si dhe cilat janë zgjidhjet që rekomandohen për të ulur nivelin e ndotjes dhe ruajtur biodiversitetin e zonave të mbrojtura.

## 8 qershor 2024, Dita Botërore e Oqeaneve

Në kuadër të Ditës Botërore të Oqeaneve, AdZM Vlorë zhvilloi një aktivitet pastrimi së bashku me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Kafil Malaj” Bishan. Nëpërmjet kësaj ore mjedisore nxënësit mësuuan më tepër rreth botës nënujore dhe gjallesat që ndodhen nën ujë. Nxënësit kuptuan rëndësinë e ruajtjes së deteve dhe oqeaneve, pasi janë shtëpia e shumë gjallesave ujore.

ndotje e mjedisit      biodiversitet i zonave të mbrojtura

dita botërore e oqeaneve      pasuri natyrore      shtëpia e gjallesave ujore